



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi udhëheqës e ekipit dhe të anëtarëve të ekipit, Besim Lezi dhe Hysen Restelica, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opineri i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	5
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	33
Shtojca II: Letër Konfirmimi	36

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore nuk ishin përgatitur plotësisht sipas kërkesave të kornizës për raportim financiar, këto pasqyra përmbajnë gabim material sa i përket klasifikimit të shpenzimeve si dhe mangësi në shpalosjet e informatave për pasurit.

Në vitin 2019, Komuna e Pejës ka shpenzuar 96% të buxhetit final. Mirëpo, përkundër këtij realizimi të mirë të buxhetit, komuna ka treguar dobësi në menaxhimin e shpenzimeve sidomos atyre me prokurim si kontraktime jo adekuate, mangësi në ridestinim të fondeve, ndryshim i pa aprovuar i përmasës/parallogaris së kontraktuar, mungesë të projekteve ekzekutive, menaxhim i dobët i kontratave etj. Me tutje, niveli i lartë i pagesave me vendime gjyqësore kishte rritur kostot e komunës për shkak të pagesës edhe të shpenzimeve gjyqësore/përmbartimore. Gjithashtu, dobësi kishte edhe në regjistrimin e pasurisë, menaxhimin e detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Implementimi i rekomandimeve të vitit paraparak ende mbetet sfidë për komunën. Nga 17 rekomandimet e dhëna vetëm gjashtë prej tyre janë zbatuar, tre ishin në proces, dy janë mbyllur ndërsa gjashtë nuk janë adresuar ende.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Pejës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes vendimeve gjyqësore Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 515,036€ në kategori ekonomike jo adekuate. Më gjerësisht shih tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në vitin 2019, Komuna e Pejës ka shpenzuar 96% të buxhetit final. Mirëpo, përkundër këtij realizimi të mirë të buxhetit, komuna ka treguar dobësi në menaxhimin e shpenzimeve sidomos atyre me prokurim si kontraktime jo adekuate, mangësi në ridestininim të fondeve, ndryshim i pa aprovuar i përmasës/parallogaris së kontraktuar, mungesë të projekteve ekzekutive, menaxhim i dobët i kontaktave etj. Më tutje, niveli i lartë i pagesave me vendime gjyqësore kishte rritur kostot e komunës për shkak të pagesës edhe të shpenzimeve gjyqësore/përmbartimore. Gjithashtu, dobësi kishte edhe në regjistrimin e pasurisë, menaxhimin e detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ²	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	26,598,410	27,705,866	26,583,241	96%	24,804,411	23,082,882
Granti i Qeverisë –Buxheti	21,755,728	21,755,728	21,394,390	98%	20,777,769	18,027,839
Të bartura nga viti paraprak ³	-	702,859	702,298	100%	224,264	1,060,825
Të hyrat vetjake ⁴	4,588,935	4,588,935	3,959,760	86%	3,546,914	3,384,643
Donacionet e brendshme	-	71,073	45,600	64%	17,591	194,279
Donacionet e jashtme	-	512,925	414,462	81%	237,873	415,296
Financimet nga huamarrja	253,747	74,346	66,731	90%	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,107,456€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak, donacioneve të brendshme dhe të jashtme dhe zvogëlimit të fondit të financuar nga huamarrja. Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 26,583,241€, apo krahasuar me vitin 2018 (97%) për 1% më ulët.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	26,598,410	27,705,866	26,583,241	96%	24,804,411	23,082,882
Pagat dhe Mëditjet	14,216,617	14,231,446	13,777,194	97%	13,644,056	13,219,353
Mallrat dhe Shërbimet	3,224,859	3,125,885	3,015,539	96%	2,834,089	2,407,120
Shërbimet komunale	751,924	752,376	729,989	97%	706,618	683,864
Subvencionet dhe Transferet	333,000	334,989	334,879	100%	300,260	286,808
Investimet Kapitale	8,072,010	9,261,170	8,725,640	94%	7,319,388	6,485,737

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 14,829€ si rezultat

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

i donacioneve të jashtme⁵. Buxhetit final për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 98,974€ si rezultat i "Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes Ministrisë së Shëndetësisë"⁶. Buxheti final për shërbime komunale është rritur 452€, për subvencione dhe transfere është rritur për 1,989€ në të dy rastet si rezultat i bartjes mes kategorive. Për kategorinë investime kapitale buxheti final ishte rritur për 1,189,160€, si rezultat i të hyrave të bartura 696,123€, donacioneve të brendshme 71,072€, donacioneve të jashtme 354,308€⁷, financimeve nga palët e treta 46,825€ dhe financimit nga huamarrja 20,832€.

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, Komuna në vitin 2019 përmes vendimeve gjyqësore ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 515,036€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Pagesa në vlerë prej 492,047€⁸ për "Rimorkim, tërheqjen e automjeteve të parkuar jashtë ligjit apo atyre të aksidentuar dhe bartja deri tek vend parkingu" ishte paguar nga kategoria e investimeve kapitale, por që për nga natyra i takon kategorisë mallra dhe shërbime;
- Pagesa në vlerë prej 4,981€⁹ për gjobën e shqiptuar për mos zbatim të Aktvendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ishte paguar nga kategoria e investimeve kapitale, por që për nga natyra i takon kategorisë mallra dhe shërbime; dhe

⁵ Marrëveshje mes Save dhe Children International në Kosovë për projektin e financimit të projektit " Përmirësimi i qasjes dhe në kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë e hershme në Kosovë"; dhe Marrëveshja për bashkëfinancimin e projekteve mes " MAPL-se, Komunës së Pejës dhe Helvetas Swiss Intercooperation".

⁶ Për financimin e kredisë numër 5442-XK për të përkrahur Projektin e shëndetësisë në Kosovë dhe Ligjit Nr.06/L-133 për ndarje buxhetore për vitin 2019, neni 14 pika 5 "shpenzimet e paparashikuara dhe rezerva". Qëllimi i Marrëveshjes është transferimi i fondeve të buxhtuara dhe pa alokuara në Ministri të Shëndetësisë.

⁷ Marrëveshja për bashkëfinancimin e projekteve mes " MAPL-se, Komunës së Pejës dhe Helvetas Swiss Intercooperation".

⁸ Në emër të dëmit kontraktues, për kontratën e lidhur më datë 15.09.2005, dhe për vazhdimin e së njëjtës, një herë me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv më dt.18.07.2007 dhe herën tjetër me dt.19.10.2009 me vendim të Kryetarit të Komunë. Komuna ka kontestuar pagesën për shkak se ka pretenduar se obligimet janë krijuar pas skadimit të periudhës së Kontratës.

⁹ Bazuar në urdhëresën për përmbardim E.nr.794/15 të Gjykatës themelore në Pejë, gjoba e shqiptuar për mos zbatim të Aktvendimit të KPMSHCK- A/02/428/1/2015 të datës 04.12.2015. Shpenzimi duhet të evidentohet në kodin ekonomik -shpenzimet e vendimeve gjyqësore (14410).

- Pagesa në vlerë prej 18,008€¹⁰ për kompensimin e pagave mujore, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, por që për nga natyra i takon kategorisë paga dhe mëditje.

Në mungesë të mjeteve në kategorinë e duhur/adekuate pagesat janë kryer nga kategoritë tjera. Gjithashtu edhe mosrespektimi i afateve ligjore të pagesave ka shkaktuar vonesa në pagesën me kohë të obligimeve dhe kanë ndikuar zhvillimin e kontesteve gjyqësore.

Ndikimi

Pagesa e vendimeve gjyqësore për kategori jo adekuate ndikon në shpenzimin e buxhetit të destinuar për qëllime tjera, duke rrezikuar implementimin e projekteve apo arritjen e objektivave komunale të parashikuar me buxhetin e këtij viti. Kjo ka rezultuar edhe me kosto shtesë buxhetore si rezultat i ngarkesave në emër të kamatave, shërbimeve gjyqësore dhe të përmbarimit.

Rekomandimi B1 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kategorive ekonomike adekuate. Kryetari duhet të sigurojë që para krijimit të obligimeve fondet janë të buxhetuara dhe mjetet janë të zotuar me qëllim të forcimit të disipline financiare për pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e shpenzimeve shtesë.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2019 ishin në vlerë 3,825,002€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Kemi testuar 43 mostra për teste substanciale në vlerë 541,354€, si dhe 27 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	4,588,935	4,588,935	3,825,002	83%	3,589,501	3,051,922

¹⁰ Vendim gjyqësorë dt. EP.nr.306/18, për kompensimin e pagave mujore të një zyrtarit, nga 11.04.2014 deri më datën 31.12.2016 apo mbi 35 muaj.

Realizimi i të hyrave gjatë vitit ka qenë më i ulët se sa planifikimi për 763,933€¹¹. Kjo për shkak se kishte rënie në pranimin e të hyrave nga qiraja, në krahasim me vitin paraprak.

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga trafiku 737,887€ dhe gjobat nga Gjykatat 51,885€) në vlerë prej 789,772€.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 14,231,446€ i cili ishte shpenzuar 97%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,231 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,118. Gjatë vitit janë rekrutuar 91¹² zyrtarë. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 80,054€, si dhe 18 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 3,125,885€, prej tyre ishin shpenzuar 3,015,539€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për udhëtime zyrtare, shpenzime të komunikacionit, shpenzime kontraktuese, mobile dhe pajisjeve të zyrës, derivate, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit të pasurive, mirëmbajtje dhe riparim, marketingut dhe publikimit, përfaqësimit, avanset dhe vendimet gjyqësore. Kemi testuar 50 mostra për teste substanciale në vlerë 493,629€ si dhe nëntë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Përderisa, buxheti final për shërbime komunale ishte në vlerë prej 752,376€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 97%.

¹¹ Analiza është bërë duke krahasuar planifikimin e të hyrave sipas Ligjit të buxhetit, ku komuna kishte planifikuar edhe të hyra tjera – indirekte në vlerë prej 554,476€. Nëse planifikimi i këtyre të hyra nuk merret në konsideratë, pranimet janë realizuar afro 95%.

¹² Në arsim ishin 70 të punësuar, në administrate 14 dhe 7 në shëndetësi.

Çështja A1 - Tejkalim i sasive/ vlerës indikativë të kontratës kornizë

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik neni 38.5.1 specifikon se - Me kontratat publike kornizë mund të shpërblehet: një operatori ekonomik dhe në këtë rast duhet të përfshihen të gjitha kushtet e nevojshme për të lejuar që porositë të bëhen vetëm në bazë të kontratës. Gjithashtu edhe RRUOPP neni 56.10 parasheh se: “ Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus 30%. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht”.

Komuna ka nënshkruar kontratën kornizë për mirëmbajtje dimërore të rrugëve për fshatrat e Komunës së Pejës (LOT II) për 36 muaj në vlerë të parashikuar me çmim të përafërt të këtyre shërbimeve prej 89,100€, kurse për periudhën vjetore vlera e përafërt është 29,700€ e parashikuar po ashtu në çmimin e kontratës, duke i bashkëangjiurt edhe listën e rrugëve të fshatrave përafërsisht 110km, ku nuk përfshihej zona e Rugovës. Mirëpo edhe pse nuk ishte paraparë në dosjen e tenderit dhe nuk ishte përfshirë në kontratë mirëmbajta e rrugëve në Regionin e Rugovës (për 9 lokacione me gjatësi 27.74km) komuna kishte shfrytëzuar të njëjtën kontratë duke paguar 29,646€¹³, me një tejkalim mbi 70% të vlerës indikativë vjetore apo mbi 41% të vlerës totale të kontratës.

Për shkak se komuna nuk kishte kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve në zonën e Rugovës, menaxheri i projektit me dt. 15.12.2018 ka bërë kërkesë për aprovim të këtyre shërbimeve drejtuar kryetarit dhe zyrës së prokurimit, mirëpo aprovimi nuk është marr nga nivelet kompetente. Komuna e arsyeton këtë veprim për shkak të motit dhe në mungesës së OE të kontraktuar.

Ndikimi

Mirëmbajtja e rrugëve të cilat nuk kanë qenë të kontraktuara përveç se është bërë jashtë procedurave ligjore dhe administrative, mund të ndikojnë në humbje financiare për komunën dhe të rrezikojnë arritjen e duhur të vlerës për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren aktivitetet e nevojshme sipas

¹³Bazuar në raportin e pranimit, shërbimi kishte filluar me datë 18.11.2018 deri me 13.03.2019 ku janë pranuar shërbime të evidentuar për 52 ditë, situacioni i II, i dt.03.04.2019 i nënshkruar nga organet mbikëqyrëse ka pranuar pastrimin e rrugëve nga bora 977km*6€ (përderisa në përkrahje është evidentuar si 64,4*15=966km), dhe pastrimi i rrugëve nga bora me hedhje të kripës 1,982km*12€ (përderisa në përkrahje është evidentuar si 64,4*15=966km). Për me tepër organi mbikëqyrës ka pranuar shërbimin të evidentuar tri herë brenda një dite (p.sh me datë 29.01.2019 ishte pranuar 1* pastrimi i borës dhe 2* pastrimi i bores me hedhje të kripës).

rregullave për lidhjen e kontratave me kohë për shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe menaxherët e projekteve të veprojnë në pajtueshmëri me LPP dhe Rregullat e udhëzuesit operativ për prokurimin publik për ndryshimet e kushteve dhe termeve të kontratës. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore.

Çështja A2 - Shërbimet e sigurimit me kontraktor të pa licencuar për këtë veprimtari

Gjetja Ligji Nr. 04/L-004 për shërbimet private të sigurisë, neni 3 ka definuar se: 1. "Shërbimet e sigurimit ofrohen vetëm nga kompanitë private të sigurimit, të licencuara dhe të autorizuar në pajtim me këtë ligj" dhe pika 2. "Shërbimet e sigurimit ushtrohen vetëm përmes punëtorëve të licencuar të sigurimit në pajtim me këtë ligj".

Komuna ka nënshkruar kontratë me kompaninë publike për shërbime të mirëmbajtjes dhe sigurimin e objekteve komunale, duke bërë pagesë për çdo muaj për pagat e punonjësve për shërbimet e kryera¹⁴ (pastrimi dhe siguri i objekteve). Këtë formë të kontraktimit komuna e kishte mbështetur në interpretimin publik nga KRPP-ja¹⁵, si dhe në blerjen e shërbimeve për rastet që kanë përjashtim nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimi publik, të ashtuquajtura blerje brenda shtëpisë.

Megjithatë, në regjistrin e biznesit kemi vërejtur se për shërbimet e sigurimit kompania nuk e kishte të paraparë ushtrimin e veprimtarisë për sigurimin e objekteve. Në sigurimin e objekteve komunale ishin të angazhuar 55 punonjës, nga këta vetëm për 19 punonjës na janë ofruar licencat.

Ndikimi Kontraktimi i shërbimeve nga operatorët të pa licencuar për ofrimin e këtyre shërbimeve do të rrezikoj që shërbimet e sigurimit të jenë jashtë standardeve të përcaktuara me ligj. Për më tepër, kjo mënyrë e kontraktimit të shërbimeve të kësaj natyre ndikon edhe në kufizim të konkurrencës dhe transparencës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që aplikohen procedurat adekuate të prokurimit dhe shërbimet e sigurimit të kontraktohen me kompanitë që plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore të cilat janë të licencuara dhe të autorizuar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-004.

¹⁴Për këto shërbime brenda vitit janë shpenzuar 940,163€.

¹⁵ Sipas LPP nenit 9 paragrafi 4 "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".

Çështja B2 - Mangësi në angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Gjetja Komuna gjatë vitit 2019 kishte angazhuar 58 punonjës me MSHV. Prej tyre gjashtë janë angazhuar me Ligjin e Punës dhe 52 prej tyre ishin bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil.

Për 52 punonjës komuna nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë formale (të thjeshtëzuar) të rekrutimit, përkundër që neni 12 pika 4 të LSHC Nr.03/L-149, përcakton që emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit¹⁶. Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara. Këta punonjës ishin të angazhuar kryesisht për pozita të rregullta të punës¹⁶. Për më tepër në pesë raste komuna brenda vitit ka lidhur dy marrëveshje me të njëjtit persona, duke marrë shërbimet e njëjta për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj brenda vitit.

Sipas zyrtarëve komunal, mangësitë e identifikuara, janë pasojë e mungesës së buxhetit për staf të ri për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës nga Ministria e Financave (MF) krahasuar me kërkesat.

Ndikimi Mbulimi i pozitave me marrëveshje të përkohshme pa procedura rritë rrezikun nëse në pozitat e tilla angazhohet staf adekuat dhe mund të rezultojë me performancë të dobët dhe mos arritje të objektivave.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat ti trajtoj dhe diskutuar me MF dhe t’i adresoj me rastin e planifikimit të buxhetit.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 334,989€, prej tyre ishin shpenzuar 334,879€. Komuna kryesisht ka mbështet aktivitetet kulturore, sportive dhe ka ofruar ndihma momentale. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 10,400€ si dhe nëntë mostra për teste të pajtueshmërisë.

¹⁶Angazhimi për, pranimin dhe evidentimin e kërkesave për bartjen e pronave, për kryerjen e punëve të zyrtarit ligjor, pranimi i aplikacioneve për zhvillimin e bujqësisë, për kryerjen e punës të inspektorit komunal, inspektorit të tregut, inspektimin e ambientit, si mbikëqyrës të projekteve etj. Ndërsa 6 kontratat e punës për detyra specifike janë lidhure me personat që do të angazhohen për ti kryer punët si: infermier të përgjithshëm, koordinimin e punëve për teknikat medicinale, ndihmës infermierë etj.

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit”.

Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor (2019) të mbështetjes financiare për OJQ-të. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorja e Shëndetësisë të cilat ofrojnë mbështetje financiare për OJQ-të, kishin dështuar në përgatitjen e planit vjetor.

Ndikimi Mos përgatitja e planit vjetor rrit rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të paplanifikuara.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,261,170€, prej tyre ishin shpenzuar 8,725,640€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizimit, trotuareve, ndërtim dhe mirëmbajtja e objekteve, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale. Kemi testuar 98 mostra për teste substanciale në vlerë 2,505,869€, si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Shpenzime pa ridestininim të aprovuar të fondeve

Gjetja Sipas nenit 16 pika 9 të Ligji Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019¹⁷ Ndryshimet në shumat e alokuara për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, dhe projektet nga fondet e bartura nga vitet paraprake si dhe të regjistruara në SIMFK duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Ato ndryshime regjistrohen në SIMFK nga ministri në afat prej pesë ditësh nga pranimi i aprovimit të dhënë nga ana e Kuvendit Komunal.

Në 17¹⁷ raste, komuna ka realizuar pagesa në vlerë prej 455,393€ për projekte kapitale duke mos siguruar paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal për ri

¹⁷Kryesisht për kontratat e asfaltimit, mirëmbajtjes, sanimit, kubizmit, rregullimit të rrugëve, ndërtim, renovim, fasadim të objekteve, hapje e shtigjeve, ndërtimi i impianteve të ujërave të zeza etj.

destinim të mjeteve. Në këto raste mjetet ishin përdor nga projektet tjera ekzistuese duke anashkaluar kërkesën ligjore të Ligjit të Buxhetit.

Sipas përgjegjësve të komunës kjo ka ndodhur si shkak i realizimit të vendimeve gjyqësore prej buxhetit të investimeve kapitale, mungesës së rishikimit të buxhetit vite me radhë dhe kushtit për përfitimin e donacioneve¹⁸.

Ndikimi Shfrytëzimi i fondeve në mungesë të miratimit paraprak nga Kuvendi Komunal për ridestinim të tyre reflekton me kontrole të dobëta në menaxhim projekteve të buxhetuara, duke rrezikuar pagesën dhe realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj që në planifikim të buxhetit përfshihen të gjitha projektet që ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për realizimin e tyre. Gjithashtu, kontrollet duhet të jenë funksionale edhe në fazën e realizimit të projekteve, duke u siguruar paraprakisht se hyrja në obligime kontraktuale është në përputhje me planifikimin e aprovuar dhe ka mjaftueshëm fonde të zotuar për realizimin e pagesave. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve të sigurohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

Çështja B3 - Ndryshim i sasive të paramasës së kontraktuar pa aprovimin e ZKA

Gjetja Në një pagesë për kontratën¹⁹ jo kornizë kemi vërejtur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar mbi 10% sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratave përkatëse. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.21, 61.22 dhe 61.23 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Menaxheri pohoj se nuk kishte njohuri për kërkesat ligjore për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e kontratës.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së punëve të kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së shpërfaq mungesë të kontrollet dhe menaxhim të dobët të kontratës. Kjo reflekton një specifikim dhe projektim jo adekuat për punët e kontraktuar dhe kontrole jo adekuat për punët e pranuar. Planifikim i dobët i nevojave nuk siguron ofertim konkurrues dhe transparent, mund të rezultojë edhe me shfrytëzimin jo ekonomik të fondeve apo kosto më të larta për shkak

¹⁸Kriteri për shpenzimin e buxhetit të investimeve kapitale prej 75%, për të përfituar donacion në vlerë 811,000€.

¹⁹ Kontrata "Ndërtimi i shtëpisë për qëndrim ditor për individët të moshës së tretë "me vlerë 80,000€. - Pagesa 19,000€- Pjesa C pika 3 tejkallim i sasisë së pozicionit nga 320 ne 382 apo 19.37%, tejkallim i cili është vërejtur dhe korriguar nga certifikuesi në pagesën pasuese, dhe pjesa H pozicioni 1 është tejkalluar për 18.75%.

të sasive/masave të përcaktuar jo drejt në dosjen e tenderit.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovohet nga ZKA.

Çështja B4 - Mungesa e projekteve ekzekutive

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në 17²⁰ kontrata pune të nënshkruara, komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Sipas zyrtarëve në mungesë të mjeteve financiare projektet ekzekutive hartohen vetëm në rastet kur kostoja e investimeve është shumë herë më e lartë se kostoja e projektit.

Ndikimi Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i objekteve pa projekte ekzekutive, rritë rrezikun e realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit (që kane të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e shfrytëzuesve, mbrojtjen e ambientit, trashëgimisë dhe pronës) dhe vonesa në realizimin e tyre që mund të shoqërohen me kosto shtesë.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohet paraprakisht projektet që janë hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Sigurimi i projektit ekzekutiv duhet të shërbej si bazë për fillimin e procesit, zhvillimin e prokurimit dhe kontraktimit të punëve, në të kundërtën fillimi i procesit të prokurimit nuk është i lejuar sipas ligjit. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë efekt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.

²⁰ Kryesisht për kontratat e asfaltimit, kubizmit, rregullimit të rrugëve, ndërtim, renovim të objekteve, ndriçimi publik hapje e shtigjeve, ndërtimi i impianteve të ujërave të zeza etj.

Çështja B5 - Menaxhim i dobët i kontratave

Gjetja

Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

- Në gjashtë²¹ kontrata për projekte kapitale është identifikuar se punimet nuk ishin realizuar sipas afateve të përcaktuara me kontratë, vonesat ishin deri në një vit. Në asnjë rast nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme për zgjatjen e periudhës së ekzekutimit si dhe nuk ishte bërë kërkesa për zgjatjen afatit të sigurimit të ekzekutimit.

Në dy raste pagesat ishin realizuar për punët e pa kryera, si në vijim:

- “Renovimi i fushave të hapura sportive në shkollat Asdreni dhe 8 Marsi”, përmes ekzaminimit fizik kemi identifikuar se mbushja me rrjet fi 8 çdo 15cm e rrethojës të shkollës “8 Marsi” nuk ishte realizuar edhe pse pagesa ishte lëshuar duke u bazuar në situacionin për pranimin e punëve. Operatori kishte vendosur një sasi të vogël të rrjetave që nuk ishin sipas specifikave të kërkuara. Sipas menaxherit të kontratës, kontraktorit i është urdhëruar zëvendësimi i rrjetave me ato që kërkohen sipas kontratës.
- “Ndërtimi i Shkollës së Artit”, shkallët (basamakët) nuk janë vendosur sipas specifikave të detajuar në projektin ekzekutiv (10x31cm), ato ishin vendosur në dimensionin (7.5cmx 27.5cm)²² dhe shkallët e dyshemesë/platos dhe ulëset në galeri nuk ishin shtruar me materialin dhe dimensionet e specifikuar në projektin detal (dërrasë 5cm në galeri dhe 2cm në shkallët e dyshemesë).

Sipas pohimeve të menaxherëve të kontratave vonesat në realizimin e kontratave kryesisht ishin për shkak të specifikave të punëve, dëmtimit të vend punimit për shkaqe objektive, zhvillimit të punëve në të njëjtën kohë nga operatorë të ndryshëm, problemeve me banorët lokal, kushteve atmosferike,

²¹ Kontrata “Asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në fshatrat Novosell, Radavc, Cigë dhe Brestovik”; Kontrata “Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Dardania II dhe në fshatin Graboc”; Kontrata “Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Dardania III dhe në fshatin Llozhan”; Kontrata “Ndërtimi i objektit të shkollës së Mesme të Artit Odhise Paskali në Pejë”; Kontrata “Asfaltimi i rrugës Haxhaj-Dugaivë” në Rugovë; Kontrata “Ndërtimi i murit mbrojtës dhe shëtitorja e Lumbardhit-nga Patriarkana deri te ura e Gegajve”.

²² Kjo çështje është identifikuar në raportin e vitit të kaluar. Gjatë ekzaminimit kemi identifikuar se Komuna i kishte vendosur shkallët, mirëpo punët nuk janë kryer plotësisht bazuar në dimensionet e përcaktuara në kontratë.

mungesës së mjeteve buxhetore etj.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet të barten në fund të vitit, që rezultojnë si barrë për buxhetin e vitit vijues dhe krejt kjo do të reflektojë edhe në arritjen e objektivave të përcaktuara të komunës. Po ashtu, pagesat për punët e pa realizuar reflektojnë shpenzimin e buxhet në kundërshtim me rregullat apo parimit të parës së gatshme dhe rezultojnë me kontrolle të dobët në pranimin e punëve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsye të aplikohen penalet për ditët në vonesë dhe shtohen kontrollet që pagesat të realizohen vetëm atëherë kur punët vërtet janë pranuar.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B6 – Shpenzime shtesë si pasojë e pagesave përmes vendimeve gjyqësore-përmbarimore

Gjetja

Në vitin 2019 janë realizuar pagesa bazuar në vendimet gjyqësore sipas nenit 40 LMFP në vlerë prej 862,899€. Ne kemi testuar pesë pagesa në vlerë 684,723€ ku borxhi kryesor ishte 537,721€ dhe kemi gjetur se këto pagesa janë përcjell me shpenzime shtesë prej 147,002€ si në vijim:

- Pagesa me vendim gjyqësor në shumën prej 492,047€, (borxhi kryesor 392,515€, kamata 85,957€ dhe shpenzime të tjera gjyqësore 13,574€). Komuna kishte kontestuar pagesën me arsyetimin se obligimi i ngarkuar është krijuar pas skadimit të periudhës kontraktuar;
- Pagesa me vendim gjyqësor P.nr.185/17 në shumën prej 134,463€, në emër të kompensimit të palujtshmërisë (shpronësimit). Borxhi kryesor ishte 102,300€, kamata 24,289€ dhe shpenzimet tjera 7,875€;
- Pagesa në shumë 35,206€ sipas vendimit të gjykatës EP.nr.502/19 në emër të kompensimit për paluajtshmëri. Borxhi kryesor ishte 30,357€, kamata 1,245€ dhe shpenzime tjera procedurale 3,604€;
- Pagesa 18,008€ me vendim gjyqësor EP.nr.306/18 në emër të kompensimit të pagave mujore për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga data 11.04.2014 deri më dt. 31.12.2016 apo 35 muaj e 25 ditë. Në këtë rast borxhi kryesor ishte 12,549€ ndërsa shpenzimet për

kontribute, tatim, kamat, ekspertizë, përbarim ish in në vlerë 5,459€; dhe

- Pagesa e shumës 5,000€ sipas vendimit E.nr.794/15 në emër të gjobës për shkak të mos zbatimit të Aktvendimit A/02/428/1/2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për SHCK, të dt.04.12.2015.

Komuna kishte kundërshtuar ekzekutimin e pagesave duke u bazuar në arsyet e dhëna megjithatë pretendimet ish in të pasuksesshme për faktin që gjykata kishte vendosur në disfavor të komunës.

Ndikimi

Pagesat e detyrueshme me vendim gjyqësor, jo vetëm që e kanë ndikuar në shpenzimin e buxhetit të destinuar për qëllime tjera, por kanë vënë në rrezik implementimin e projekteve apo arritjen e objektivave komunale të parashikuar me buxhetin e këtij viti. Kjo ka rezultuar edhe me kosto shtesë buxhetore si rezultat i ngarkesave në emër të kamatave, shërbimeve gjyqësore dhe të përbarimit.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.

Çështja A5 - Lidhja e kontratave me zotime të pamjaftueshme të fondeve

Gjetja

Sipas nenit 37.1 të LMFP : “Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”.

Komuna kishte lidhur kontrata me zotime të pa mjaftueshme të mjeteve. Për kontratën “Ndërtimi i shkollës së Artit faza II” në vlerë 441,751€, zotimi i mjeteve ishte 156,000€ dhe për kontratën “Rregullimi i qendrës së qytetit” në vlerë prej 519,005€, zotimi i mjeteve ishte 166,336€.

Zyrtarët e komunës e arsyetojnë me alokimin e vonuar të fondeve nga të hyrat vetjake, që ka rezultuar me nënshkrim të kontratave pa zotim të plotë të mjeteve.

Ndikimi

Zotimet e pa mjaftueshme të fondeve krahasuar me vlerën e kontratës kanë ekspozuar komunën para një rreziku të hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara dhe ndikon në vonesa të realizimit të projekteve të planifikuara. Nënshkrimi i kontratave në vlerë më të lartë se ajo e buxhetuar rrezikon mos përmbushjen e obligimeve ndaj OE dhe mundësisë që këto pagesa të ekzekutohen direkt nga Thesari apo përbaruesit, duke shkaktuar kosto shtesë dhe duke dëmtuar realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë, në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë realizimin e plotë të tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fondet tjera të financimit.

Çështja B7 - Periudha e sigurimit të ekzekutimit jo në përputhje me rregullat

Gjetja Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik neni 30 (Siguria e Ekzekutimit) pika 30.6 e ka definuar se " Siguria e Ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, dhe mbetet valide për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës.

- Te kontrata "Rregullimi i qendrës së qytetit" 519,005€, sigurimi i ekzekutimit nuk e mbulonte kërkesën ligjore të validitetit për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës; dhe
- Në dosjen e tenderit për kontratën kornizë "Mirëmbajtja Verore e Rrugëve" në vlerë 237,851€ ishte kërkuar siguria e ekzekutimit në afat prej 37 muaj. Përfituesi i kontratës ka depozituar sigurinë e ekzekutimit të tenderit vetëm për 365 ditë. Pas identifikimit të rastit nga auditorit, komuna ka ndërmarr masa duke e vazhduar sigurinë e ekzekutimit me dt. 29.10.2019 për periudhën e kontratës (28.05.2020 deri me 27.06.2022).

Shkaku i një dukurie të tillë ishte pakujdesia dhe neglizhenca nga zyrtarët përkatës.

Ndikimi Implementimi i kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit përveç që është shkelje e kriterëve kontraktuale e njëjta rrit rrezikun që humbjet eventuale për ekzekutimin e projektit të mos mbulohen me një garancion. Në rast kontesti për mos përmbushjen e kontratës komuna rrezikon të pranoj punime në sasi dhe cilësi të ulët.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të rishikojë arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat e LPP-së. Periudha e vlefshmërisë së sigurimit mbi ekzekutimin e kontratës duhet të zbatohen sipas ligjit.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 333,858,440€ pasurive jokapitale është 267,516€, si dhe e stoqeve 60,966€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 2,858,642€, si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B8 – Mangësi në regjistrat kontabël të pasurive

Gjetja Neni 6.1 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Gjatë testimit të saldove fillestare kemi gjetur se:

- Në regjistrin e SIMFK ishin të regjistruara pagesat në vlerë 123,308€ për shërbimet e kontraktuara “Larja dhe fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra, varrezave dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik”;
- Në regjistrin e SIMFK nuk ishte regjistruar vlera e financimit 135,698€ në objektin e SHFMU “Hil Mosi” Jabllanicë e Vogël, financuar nga projekti “Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje të tjera të obligueshme programi mbështetës- Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në objektet publike (III)”²³. Pas identifikimit nga auditori, komuna këtë pasuri e ka regjistruar në regjistrin e SIMFK, me datë 08.07.2020;
- Furnizimet nga kodet e mobilieve dhe pajisjeve për vitin 2019 ishin 77,082€, përderisa të regjistruara në e-pasuri ishin vetëm 15,010€, të paregjistruara në regjistrin kontabël ishin në vlerë 62,072€; dhe
- Pasuria nën 1,000€ nuk ishte raportuar saktë në PFV, për shkak se nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi, siç kërkohet me rregulloren 02/2013 me nenin 22 dhe 24.3. Zyrtari i pasurisë nuk i kishte evidentuar të dhënat në softuerin e-pasuria – moduli regjistri kontabël, ku duhet të aplikohet edhe zhvlerësimi për pajisjet nën 1,000€. Raportimi i pasurisë me kosto historike sipas zyrtarëve përgjegjës ka ardhur si rezultat i problemeve me migrimin e të dhënave nga sistemi i vjetër, mirëpo nga vrojtimit tona kjo ka të bëjë edhe me neglizhencën e zyrtarëve për tu ballafaquar me problemet.

Mos regjistrimi i pasurisë në SIMFK dhe e-pasuri sipas zyrtarëve ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të zinxhirit të qarkullimit të dokumentacionit mes zyrtarëve të pagesave dhe pasurisë.

²³ Marrëveshja e mirëkuptimit në mes të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik dhe Komunës së Pejës për kalimin e pronësisë kapitale.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon, shkakton mbi/nënvlërim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të pasurive në pasqyra financiare.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe janë prezantuar drejt me vlerë neto në PFV.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 17,938,351€. Kjo vlerë përbehet me tatimin në prone 11,022,241€, takse për ushtrim të veprimtarisë 6,391,030€, qiratë 3,296€, participim për çerdhe 1,633€, kërkesa nga parkingu 25,000€ dhe kërkesa nga padit gjyqësore 495,150€.

Çështja B9 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna e Pejës kishte llogari të arkëtueshme në vlerë 17,938,351€, krahasuar me vitin 2018 kishte rritje prej 302,461€ apo 2%. Komuna kishte ndërmarrë veprime përmes përmbauesve dhe kishte lidhur marrëveshje me konsumatorë për pagesë të borxheve me këste. Efektet në mbledhje e të arkëtueshmeve priten të reflektojnë në vitet në vijim.

Ndikimi Rreziku nga mos arkëtimi i të hyrave ndikon që shumë projekte kapitale të mos realizohet për shkak të mungesës së mjeteve.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë që shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 782,485€ të prezantuara në pasqyra financiare. Në këtë vlerë janë edhe detyrimet e papaguara nga viti 2018. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2018 obligimet janë zvogëluar për 70,564€.

Çështja C1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë.

Në 11 raste në pagesën e faturave të pranuar në shumë 134,098€, kishte vonesa deri në dy muaj pas afatit ligjor

Ndikimi Vonesat në pagesën e obligimeve brenda afatit ligjor mund të rezultojë me rritje të obligimeve komunale, mundësinë e përballjes me gjykata dhe implikime buxhetore për vitin fiskal vijues

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të ngritë kontrollë shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontingjente ishin në vlerë prej 906,954€ që krahasuar me vitin paraprak ishin zvogëluar për 1,907,297€. Megjithatë, kjo pasqyron një nga vështirësitë buxhetore që komuna do të përballet në të ardhmen.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Komuna e Pejës në fund të vitit 2019 sipas evidencave të prezantuara 5,348,878€ ka bartur detyrime kontraktuale në vitin 2020, të cilat kryesisht ishin projekte dhe kontrata pune për investime kapitale.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me Drejtorin e NjAB-së dhe një auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës.

Në vitin 2019, ishin finalizuar dhjetë raporte aq sa janë planifikuar në planin vjetor të auditimit. Auditimet kanë mbuluar drejtoritë e ndryshme dhe ishin të fokusuara kryesisht në fushën e shpenzimeve, prokurimit, subvencioneve, të hyrave dhe personelit.

Në këto raporte ishin dhënë gjithsej 42 rekomandime prej tyre 21 ishin zbatuara, 15 ishin në proces të zbatimit dhe 6 rekomandime ishin të pa zbatuara. Komiteti i Auditimit ishte aktiv gjatë vitit duke mbajtur pesë takime.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të ka rezultuar në 17 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar dy raporte për progresin mbi zbatimin e rekomandimeve (me 30.09.2019 dhe 06.05.2020) sipas kërkesave bazuar në Rregulloren e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, gjashtë rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces, gjashtë nuk janë adresuar ende dhe dy janë mbyllur.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Të gjitha pasuritë jo financiare, duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat për të shmangur mbivlerësimin e tyre. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që në PFV-të 2019, adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gabimet financiare të identifikuar.</p> <p>Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Janë regjistruar në regjistrat e pasurisë rastet që ishin ngritur me ndikim të theksimit të çështjes nga viti paraprak.	I zbatuar
2	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe të siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave.	Komuna ka instaluar Software përmes të cilit behet menaxhimi i pronave të dhëna me qira, të cilat janë dhënë konformë ligjeve në fuqi dhe evidenca e pronave është e saktë.	I zbatuar
3	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj përmes drejtorit të tatimit në prone se të gjithë pronarët në data bazën e sistemit janë regjistruar sipas numrit identifikues dhe të ndërmarrë veprime shtesë që kjo të bëhet sa më shpejt duke i eliminuar gabimet gjatë procesimit e të dhënave.	Janë ndërmarrë masa për të eliminuar rastet kur nuk është zbatua neni 9.82 Qytetarët me vet iniciativë kanë bërë deklarimin e pronës primare. Komuna ka evidentuar të gjitha pronat që nuk kane ID. Në	I zbatuar

			këtë rast përmes regjistrit civil do të identifikojë edhe numrat personal të pronarëve.	
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit, në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm, deri në fund të vitit me qëllim të menaxhimit të stafit dhe matjes së performancës.	Komuna ka siguruar inventar special për ruajtjen e dosjeve. Për zbatimin e rekomandimit me kërkesë të kryetarit nga NjAB është bërë një auditim ad-hoc. Mirëpo ende ekzistojnë mangësi në kompletimin e këtyre dosjeve.	I mbyllur pjesërisht i zbatuar
5	Mallra dhe shërbime	Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF.	Komuna ka zhvilluar procedurat e rekrutimit në disa raste ku ka pasur vende të lira. Mirëpo në shumicën e rasteve ka mangësi në zhvillim të procesit të rekrutimit.	I pa zbatuar.
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit sipas nevojave dhe të sigurojë se në PIP vendosën vetëm ato projekte kapitale për të cilat sigurohet se kanë të bëjnë me përvetësimin e pasurisë për nevojat e komunës. Planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Janë ndërmarrë masa se shpenzimi i mjeteve bëhet konform Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, keq klasifikimi mund të ndodh me rastin e tërheqjes së mjeteve	I pa zbatuar

			nëpërmes vendimeve gjyqësore nga Thesari MeF.	
7	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se zyrtari çertifikues dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare të identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës apo bëhet ndalesa në pagesat e radhës gjatë realizimit të këtyre kontratave.	Komuna ka marrë masat e nevojshme dhe ka ber evitimin e dobësive.	I zbatuar
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovohet nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	Me partneret tanë janë organizuar trajnime shtesë për të gjithë mbikëqyrësit e kontratave. Procesi i certifikimit të pagesave mbikëqyret dhe në raste të caktuara reagohe në parregullsitë eventuale.	I pa zbatuar
9	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutues. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë ndikim edhe në hartimin e specifikimeve të qarta, por edhe do të eliminohen pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë. Po ashtu, duhet të hartohen planet për menaxhimin e kontratave.	Projektet ekzekutive do të bëhen për ato projekte ku kostoja e investimit kapital është shumë herë me e madhe se kostoja e projektit.	Pjesërisht i zbatuar
10	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së implementimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e	Komuna ka shkëputur dy kontrata punë për shkak të vonesave të paarsyeshme në	Pjesërisht i zbatuar

		Komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyeuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë.	ekzekutim po ashtu janë iniciuar vërejtjet dhe ndëshkimet konform ligjeve në fuqi.	
11	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se kriteret janë përmbushur në përputhje të plotë me kërkesat dhe se gjatë procesit të vlerësimit evidentohen dhe parandalohen të gjitha këto mangësi në lidhje me përmbushjen e kriterëve.	Ishte vlerësimi se blerjet përmes prokurimit do të bëhen në pajtim me LPP.	I zbatuar.
12	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se do të përtërihet marrëveshja mes komunës dhe përfituesit e cila duhet të përcaktojë obligimet lidhur me raportimin e përfituesit në baza të rregullta, si dhe të përcaktojë ndonjë mekanizim mbikëqyrës/garantues për të siguruar realizimin e qëllimit dhe kushteve të marrëveshjes. Po ashtu, të sigurohet se për rastet e ngjashme aplikohen procedurat e shpalljes publike.	Është përtërirë marrëveshja me fermerin dhe shoqatën në mënyrë që destinimi i frigoriferit të ketë qëllimin e rritjes së kultivuesve të mjedrës ashtu edhe sic ka qenë deri më tani. Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur raste të tilla.	I zbatuar.
13	Çështjet e përbashkëta për mallrat shërbimet dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe marr masat e duhura për menaxhimin e duhur të obligimeve si dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.	Faturat do të paguhën me kohë në rastet kur janë pagesa të rregullta dhe nuk kontestohen nga Komuna. Megjithatë, pagesat përmes përmbaruesve me vendim të gjykatave për pagat jubilarë dhe ato përcjellëse para vitit 2018 mund të shkaktojnë pagesa drejtpërdrejt nga thesari.	I pa zbatuar

14	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive përfshirë edhe inventarizimin e plotë dhe në kohën e duhur me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.	Është raportuar je janë formuar komisionet përkatëse me kohë sipas Rregullores në fjalë si dhe janë definuar edhe afatet kohore për përmbylljen e këtij procesi.	I pa zbatuar
15	Llogarit e arkëtueshmë e	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.	Komuna kishte filluar me vërejtje për kryerjen obligimeve si paralajmërim dhe ka angazhuar përmbarues privat për 25 raste mirëpo gjendja mbetet ende e njëjtë.	I pa zbatuar.
16	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurohet se është vendosur disiplinë financiare që mundëson që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Janë ndërmarr masa edhe raportimet janë bërë në baza mujore, faturat ekzekutohen konform mjeteve në dispozicion. Mirëpo ende ka raste ku faturat e pranuar tejkalojnë afatin e përcaktuar ligjor	Pjesërisht i zbatuar
17	Raportimi menaxherial dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.	Është krijuar formati i ri i raportimit financiar dhe operativ si i cili aplikohet nga të gjitha drejtoritë.	I mbyllur i zbatuar.

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. Kryetari duhet të sigurojë që para krijimit të obligimeve fondet janë të buxhetuara dhe mjetet janë të zotuar me qëllim të forcimit të disipline financiare në pagesën e obligimeve me kohë dhe evitim të përballijës me drejtësinë duke eliminuar edhe mundësin e shpenzimeve shtesë.
2	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se ndërmarrën aktivitetet e nevojshme sipas rregullave për lidhjen e kontratave me kohë për shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe menaxherët e projekteve të veprojnë në pajtueshmëri me LPP dhe Rregullat e udhëzuesit operativ për prokurimin publik për ndryshimet e kushteve dhe termeve të kontratës. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore.
3	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë që të aplikohen procedurat adekuate të prokurimit dhe shërbimet e sigurimit të kontraktos me kompanitë që plotësojnë kriteret e përcaktuar ligjore të cilat janë të licencuara dhe të autorizuara në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-004.
4	Mallra dhe Shërbime	Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat ti trajtoj dhe diskutuar me MF dhe t'i adresoj me rastin e planifikimit të buxhetit.
5	Subvencion e dhe Transfere	Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara.
6	Investime Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që në planifikimi të buxhetit përfshihen të gjitha projektet që ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për ekzekutimin realizimin e tyre. Gjithashtu, kontrollet duhet të jenë funksionale edhe në fazën e realizimit të projekteve, duke u siguruar paraprakisht se hyrja në obligime kontraktuale është në përputhje me planifikimin e aprovuar dhe ka mjaftueshëm fonde të zotuar për realizimin e pagesave. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve të sigurohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.
7	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovohet nga ZKA.
8	Investime Kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohet paraprakisht projektet që janë hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Sigurimi i

		projektit ekzekutiv duhet të shërbej si bazë për fillimin e procesit, zhvillimin e prokurimit dhe kontraktimit të punëve, në të kundërtën fillimi i procesit të prokurimit nuk është i lejuar sipas ligjit. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë efekt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.
9	Investime Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuara nga ana e komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë dhe shtohen kontrollet që pagesat të realizohen vetëm atëherë kur punët vërtet janë pranuar.
10	Çështjet e Përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.
11	Çështjet e Përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë realizimin e plotë të tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.
12	Çështjet e Përbashkëta	Kryetari duhet të duhet të rishikojë arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat e LPP-së. Periudha e vlefshmërisë së sigurimit mbi ekzekutimin e kontratës duhet të zbatohen sipas ligjit
13	Pasuritë Kapitale dhe jo Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe janë prezantuar drejt me vlerë neto në PFV.
14	Llogari të arketueshme	Kryetari duhet të sigurojë që shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arketueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.
15	Detyrime e papaguara	Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre

z. Gazmend Muhaxheri

Kryetar i Komunës së Pejës

Data: 15/7/2020,

